



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KURBIN

Nr. 7481/PK

V E N D I M

dt. 21.12.2020

Nr. 13, datë 21.12.2020

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONAT E  
DËMTUARA PIKËSORE, PËR 109 BANESA INDIVIDUALE , BASHKIA KURBIN”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja “b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Nr. 53, datë 10.10.2020 vendosi “Të Miratojë rindërtimin në të njëjtin truall, të njërive individuale të banimit, të vlerësuara “per shembje”, sipas kërkesës me nr. 5736 prot, datë 30.09.2020 të Bashkisë Kurbin, për rindërtimin e 109 njërive individuale, të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.112, datë 30.09.2020.

**V E N D O S A:**

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 109 banesa Individuale, Bashkia Kurbin, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
  - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore;
  - b) Materiali hartografik:
    - i. Harta e Përdorimit të Tokës dhe Projektimit Urban;
    - ii. Harta e Infrastrukturave dhe Mbrojtjes së Tokës;
  - c) Paketa e Planvendosjeve për banesat individuale.
2. Miratohet rindërtimi në Zonat e dëmtuara pikësore, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, me qëllin rindërtimin e objekteve të cilat referuar

akt-ekspertizës së thelluar dhe oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 109 banesa Individuale, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.
4. Plani i Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 109 banesa Individuale të integrohet me dokumentin e Planifikimit në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, *"Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit"*, të ndryshuar.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

**KRYETARI**

**MAJLINDA CARA**

